



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS
OSNOVNI SUD GJAKOVA – BASIC COURT OF GJAKOVA

AGJ.nr.348/24
Datë 30.12.2024

**PLANI VJETOR I PUNËS SË GJYKATËS THEMELORE NË
GJAKOVË DHE DEGËVE TË SAJË PËR VITIN 2025**

Përmbajtja

Hyrja.....	4
1. Struktura organizative	5
2. Përbërja e trupit gjykues.....	8
2.1. Ndarja e lëndëve sipas trupit gjykues.....	8
2.2. Departamenti për të Mitur:.....	8
2.3. Departamenti i Përgjithshëm.....	8
2.4. Divizioni Civil:.....	9
2.5. Divizioni i Kundërvajtjes:.....	9
3. Administrata e gjykatës.....	9
DEGËT E GJYKATËS.....	13
4. Organizimi i Punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega Rahovec.....	13
6.1. Zyra e ndihmës Administratorit	14
7. Organizimi i punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega Malishevë.....	16
7.1. Zyra e ndihmës Administratorit	17
8. Zbatimi i Planeve Strategjike të KGJK-së, Akteve dhe rekomandimeve të tjera	18
9. Shqyrtimet Gjyqësore, Publikimi i Orarit të Mbajtjes së tyre, Publikimi i Vendimeve Gjyqësore dhe Respektimi i Gjuhëve Zyrtare	19
10. Ndarja e Lëndëve	19
11. Radha e Zgjidhjes së Lëndëve.....	20
12. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe arkivimi.....	20
13. Kolegjet Shqyrtuese	20
14. Bashkëpunëtorët profesional.....	21
15. Mbledhja e Kolegjiut të Gjyqtarëve dhe Takimet Departamenteve apo Divizioneve	21
16. Ndihma Juridike Ndërkombëtare	22
17. Respektimi i Kodit të Mirësjelljes dhe Orarit të Punës	22
18. Zbatimi i Programit TIK/SMIL.....	22

19.	Transparenca dhe Llogaridhënia	23
20.	Organizimi i Punës së Administratës, Trajnimet dhe Vlerësimi i Performancës	23
21.	Dispozitat Përfundimtare	23
22.	Plotësimi dhe ndryshimi i Planit të Punës.....	24
23.	Hyrja në fuqi	24

Hyrja

Në bazë të nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 10 dhe 17 të Rregullores Nr.17/24 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, pas marrjes së propozimit të kolegjiut të kësaj Gjykate, me datën 30 dhjetor 2024, përcakton Planin Vjetor të Punës për vitin 2025.

Me Planin Vjetor të Punës për Gjykatën Themelore në Gjakovë, me dy degët e saja në Rahovec dhe Malishevë për vitin 2025, do të bëhet organizimi dhe rregullimi i veprimtarisë së brendshme i gjykatës dhe administratës së saj, duke përcaktuar funksionet gjyqësore, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve, përbërjen e kolegjeve, ndarjen e lëndëve të procedurës paraprake, orarin e punës, kodin e mirësjelljes, caktimin e shqyrtimeve gjyqësore dhe publikimi i mbajtjes së tyre, publikimi i aktgjykimeve, planifikimi i mbledhjeve të kolegjiut, zbatimi i programit të sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve – SMIL. Me këtë Plan synohet që të vazhdohet ngritja e imazhit të gjyqësorit, përmes efikasitetit në trajtimin e lëndëve, transparencës dhe llogaridhënies, duke bërë edhe zbatimin e planeve strategjike të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Me këtë Plan rëndësi e veçantë i është kushtuar trajtimit sa më efikas të lëndëve dhe sigurimit për një qasje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha palëve, ashtu që përmes objektivave të qarta dhe të matshme, Plani për vitin 2025 vendos një themel për një sistem më efikas dhe të besueshëm duke respektuar standardet më të larta ndërkombëtare të drejtësisë dhe etikes profesionale.

1. Struktura organizative

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës, udhëheq kryetari i Gjykatës, Nikollë Komani. Në mungesë të kryetarit, me organizimin e punës së gjykatës dhe administratës, udhëheqë nënkryetari i gjykatës, Drilon Haraçia.

Zyra e kryetarit përbehet nga:

Udhëheqësi i zyrës për Informim dhe Komunikim me Media

- Lekë Muqaj

Zyrtarja ekzekutive:

- Sonesta Kupa

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore në Gjykatën Themelore në Gjakovë, janë organizuar tri departamente:

- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti i Përgjithshëm;
- Departamenti për të Mitur.

Në krye të çdo Departamenti caktohet një gjyqtar si udhëheqës i Departamentit.

Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm funksionojnë këto divizione:

- Divizioni Penal;
- Divizioni Civil;
- Divizioni për Kundërvajtje.

Në krye të çdo Divizioni, do të caktohet një gjyqtar përgjegjës, për të siguruar veprime efikase të Gjykatës.

Udhëheqësit e departamenteve do t'i raportojnë kryetarit të Gjykatës, për punën e departamenteve të cilat i drejtojnë, së paku një (1) herë në tre (3) muaj.

Pjesë e raporteve të udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm, duhet të jenë raportet e gjyqtarëve, përkatës të gjitha divizioneve.

Kryetari i Gjykatës mund të kërkojë nga udhëheqësit e departamenteve ose gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për ecurinë e lëndëve të veçanta.

Në Gjykatën Themelore në Gjakovë tani janë të sistemuar 13 gjyqtarë, cilët do të punojnë në kuadër të departamenteve dhe divizioneve të gjykatës si vijon:

Në Departamentin e Krimeve të Rënda do të punojnë gjyqtarët:

- Drilon Haraçia
- Ilir Rashkaj (deri me datë 01.08.2025)
- Sulltan Dobraj
- Njazi Morina (nga data 01.02.2025)
- Nikollë Komani

Gjyqtari Njazi Morina caktohet në Departamentin e Krimeve të Rënda, ku do të merr pjesë në trupa gjykues dhe do të ngarkohet me ndonjë lëndë kur kanë pengesa gjyqtarët e këtij Departamenti në Gjakovë, mirëpo i njëjti do të vazhdoj që të jetë edhe gjyqtar mbikëqyrës në degën e Malishevës.

Gjyqtari Ilir Rashkaj në këtë gjykatë do të punoj deri me datë 31.07.2025, pasi që i njëjti nga data 01.08.2025, sipas vendimit të KGJK-së do të transferohet si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren.

Gjyqtarët e Krimeve të Rënda, sipas nevojës do të gjykojnë lëndët e Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit Penal, për qëllimet e efikasitetit të gjykatës.

Në Departamentin e Përgjithshëm do të punojnë gjyqtarët të cilët janë të ndarë në divizione.

Në Divizionin Penal do të punojnë gjyqtarët:

- Samedin Cena
- Driton Sadiku
- Blerina Kurtaj (nga data 01.04.2025)

Në Divizion Civil do të punojnë gjyqtarët:

- Durim Balaj (deri me datë 01.07.2025)
- Mirjeta Shala
- Fëllanza Knushaj
- Blerina Kurtaj (deri me datë 30.03.2025)
- Florid Hasku
- Mirvet Thaqi

Gjyqtarja Blerina Kurtaj do të punoj në Divizionin Civil deri me datë 01.04.2025, nga kjo datë për shkak të nevojave në Divizionin Penal do të caktohet me vendim të veçantë si gjyqtare në këtë divizion.

Gjyqtari Durim Balaj do të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Themelore në Gjakovë deri me datë 30.06.2025, ndërsa nga data 01.07.2025 sipas vendimit të KGJK-së, i është lejuar transferimi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Në Divizionin e Kundërvajtjes në mungesë të gjyqtarëve të kundërvajtjes do të punojnë gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit Penal:

- Samedin Cena
- Driton Sadiku
- Shaqir Mazreku
- Blerina Kurtaj (nga data 01.04.2025)

Në Departamentin për të Mitur do të punojë gjyqtarja:

- Besarta Doli

Gjyqtarët e ri, Kaltrina Halilaj, Liridon Pnishi dhe Mervan Curri janë duke vijuar trajnimin në Akademinë e Drejtësisë dhe në muajin mars do të fillojnë pjesën praktike në gjykatë dhe atëherë do të vendoset për sistemimin e tyre në Divizionet përkatëse, si dhe gjyqtarët që do të caktohen në Divizion Civil do të ngarkohen me lëndë civile të gjyqtares Blerina Kurtaj dhe gjyqtarit Durim Balaj.

Për udhëheqës të departamenteve dhe gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve janë caktuar:

- Sulltan Dobraj, Departamenti i Krimeve të Rënda
- Mirjeta Shala, Departamenti i Përgjithshëm
- Besarta Doli, Departamenti për të Mitur
- Mirjeta Shala, Divizioni Civil
- Samedin Cena, Divizioni Penal dhe për Kundërvajtje

2. Përbërja e trupit gjykues

Për gjykim në Departamentin e Krimeve të Rënda, trupi gjykues do të përbëhet nga tre gjyqtarë profesional.

Me qëllim të funksionit të papenguar të këtij departamenti krahas gjyqtarëve aktual të Departamentit të Krimeve të Rënda, është caktuar edhe gjyqtari Njazi Morina i cili me këtë Plan të Punës nga muaji shkurt i vitit 2025, do të jetë gjyqtar i krimeve të rënda. Mirëpo i njëjti fillimisht nuk do të ngarkohet me lëndën të krimeve të rënda me përjashtim të ndonjë rasti kur gjyqtarët kanë pengesa, por do të caktohet anëtar i trupave gjykues.

Gjyqtarja për të mitur, Besarta Doli do të jetë anëtare e trupave gjykues në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe sipas nevojës mund të ngarkohet me ndonjë lëndë nga ky departament.

Në Departamentin e Përgjithshëm do të gjykojë gjyqtari i vetëm.

Në Departamentin për të Mitur, trupi gjykues përbëhet konform Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

2.1. Ndarja e lëndëve sipas trupit gjykues

Departamenti i Krimeve të Rënda:

- Drilon Haraçia, trupi I-rë;
- Ilir Rashkaj, trupi i II-të. deri me datë 31.07.2025;
- Sulltan Dobraj, trupi i III-të;
- Njazi Morina, trupi i IV (në rastet kur nuk mund të ngarkohen me lëndë tre gjyqtarët e lartcekur të DKR-së);
- Nikollë Komani, trupi i V; (meqenëse është edhe Kryetar i Gjykatës, atëherë për shkak të angazhimeve shtesë, nuk do t'i nënshtrohet marrjes së rregullt të lëndëve – por do të ngarkohet herë pas here me lëndë, si dhe do të angazhohet si anëtar i trupave gjykues).

Gjyqtarët do të punojnë të gjitha lëndët e natyrës penale në kompetencë të këtij Departamenti, por edhe në procedurë paraprake sipas radhës.

2.2. Departamenti për të Mitur:

- Besarta Doli, trupi i I-rë

2.3. Departamenti i Përgjithshëm

- Divizioni Penal:
 - Samedin Cena, trupi i I-të
 - Driton Sadiku, trupi i II-të

- Blerina Kurtaj, trupi i III-të, nga data 01.04.2024

Gjyqtarët e lartcekur, do të punojnë të gjitha lëndët e natyrës penale, edhe në procedurë paraprake, sipas radhës.

2.4. Divizioni Civil:

- Mirjeta Shala, trupi i I-rë, do të ngarkohet me lëndë të natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim, si dhe me lëndë të dhunës në familje;
- Durim Balaj, trupi i II-të, do të ngarkohet me lëndë të natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim deri me datë 30.06.2025;
- Fëllanza Knushaj, trupi i III-të, do të ngarkohet me lëndë të natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim, si dhe në rast të pengesave do ta zëvendësoi gjyqtaren Mirjeta Shala, për lëndë të dhunës në familje;
- Florid Hasku, trupi IV-të, do të ngarkohet me lëndë të natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim;
- Blerina Kurtaj, trupi V-të, do të ngarkohet me lëndë të natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim, si dhe në rast të pengesave do ta zëvendësoi gjyqtaren Mirjeta Shala, për lëndë të dhunës në familje, deri me datë 30.03.2025;
- Mirvet Thaqi, trupi VI-të, do të ngarkohet me lëndë të natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim.

Meqenëse gjyqtarja Mirjeta Shala është e ngarkuara me lëndët e dhunës në familje, atëherë lidhur me lëndët e natyrës urgjente – masat e sigurisë e njëjta nuk do të ngarkohet me përjashtim të rasteve kur masa vije pas padisë. Me masat e sigurisë do të ngarkohen sipas renditjes gjyqtarët Durim Balaj, Fëllanza Knushaj, Florid Hasku, Blerina Kurtaj dhe Mirvet Thaqi.

2.5. Divizioni i Kundërvajtjes:

- Samedin Cena
- Driton Sadiku
- Shaqir Mazreku
- Blerina Kurtaj, nga data 01.04.2025

Njëkohësisht gjyqtarët e lartcekur do të punojnë edhe në ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes.

3. Administrata e gjykatës

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës, menaxhimi i punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objektit, administrohet dhe udhëhiqet nga administratori Rudin Elezi.

Struktura organizative e administratës së gjykatës përbëhet nga:

1. Zyra e Administratorit;
2. Zyra për Mbështetje Juridike;
3. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve;
4. Zyra për Shërbimet e Përbashkëta;
5. Zyra për Buxhet dhe Financa;
6. Zyra për Informim dhe Komunikim me Media.

1. Zyra e administratorit përbëhet nga:

- Rudin Elezi, administrator
- Arlind Haxhiavdyli, zyrtari certifikues
- Vlora Deva, zyrtare e personelit

2. Zyra për Mbështetje Juridike, aktualisht nuk ka një udhëheqës të saj. Në përbërje të saj ka:

- 2.1. Bashkëpunëtorët profesional të cilët janë të caktuar si në vijim:

- Besim Rrahmani (shqyrtimi paraprak i shkresave, lëmin penale, ekzekutimin e dënimeve, bashkimin e dënimeve, njohjen e vendimeve të huaja)
- Nëntor Oseku (shqyrtimi paraprak i shkresave dhe publikim i vendimeve gjyqësore)
- Fjolla Osmani (lëmia civile)
- Argjelina Prenku (lëmia penale)
- Sefedin Avdijaj (lëmia civile dhe penale)
- Zef Qupi (lëmia civile)
- Ardiana Thaqi (gjendet në pushim të lehonisë)
- Gresa Sadiku (lëmia civile)
- Liridona Palushi (lëmia penale)
- Ihsan Vuçitërna (lëmia civile)
- Dardan Beli (lëmia penale)
- Jon Canhasi (lëmia civile)

- 2.2. Zyrtarët ligjor/sekretaret juridike të cilët janë të përcaktuar si në vijim:

- Arbënore Basha, zyrtare ligjore në Departamentin e Krimeve të Rënda
- Merita Xheravina, zyrtare ligjore në Departamentin e Krimeve të Rënda
- Miranda Ibrahim, zyrtare ligjore në Departamentin e Krimeve të Rënda
- Shkëndije Halilosmani, zyrtare ligjore në Departamentin për të Mitur
- Fatlind Kryeziu, zyrtar ligjor në Divizionin Penal
- Mandushe Doli, sekretare juridike në Divizionin Penal
- Flutura Nagavci, sekretare juridike në Divizionin Penal
- Tringa Rogova, zyrtare ligjore në Divizionin Civil
- Rina Rama, zyrtare ligjore në Divizionin Civil
- Valdet Delijaj, zyrtar ligjor në Divizionin Civil
- Drilon Zymeri, zyrtar ligjor në Divizionin Civil
- Vjollca Gaxha, sekretare juridike në Divizionin Civil
- Drita Haxhishabani, sekretare juridike në Divizionin Civil
- Violeta Bobani, sekretare juridike në Divizionin e Kundërvajtjes
- Valbone Hoxha, sekretare juridike¹
- Doris Ahmetaj, zyrtare ligjore²

2.3. Zyra për përkthim:

- Albena Guta

3. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve përbëhet nga:

- Hektor Vula, udhëheqës i zyrës
- Manushaqe Hasanaj, mbikëqyrëse e sektorit për pranim, regjistrim, dorëzim dhe menaxhim

3.1. Referentët janë:

- Valon Sefa, referent përmbarimore

¹ Në mungesë të referentëve e caktuar të punoj si referente në lëmin civile

² Në mungesë të referentëve e caktuar të punoj si referente në lëmin civile

- Zana Ymeraga, referente civile
- Lekë Muqaj, referent ndërmjetësimi³
- Doris Ahmetaj, referente përmbartimore – civile
- Diana Zuka, referente kundërvajtjes
- Valbone Hoxha, referente civile

3.2. Arkiva përbëhet nga:

- Xhavit Sylmetaj, aktivist i lartë
- Arben Tolaj, aktivist

3.3. Dorëzuesit janë:

- Gëzim Duraku
- Afrim Rudi
- Gani Ahmeti

4. Zyra për Shërbime të Përbashkëta përbëhet nga:

- Brahim Pepshi, udhëheqës i zyrës
- Fatbardh Rogova, zyrtar i IT
- Flaka Zeka, operatore i TV-së
- Cyme Himaj, zyrtar i logjistikës
- Ernis Dervishi, receptionist
- Bashkim Efendija, roje sigurimi
- Shaban Imeraj, roje sigurimi
- Agim Blyta, roje sigurimi
- Mahir Qaushi , roje sigurimi
- Ymer Gashi, roje sigurimi

³ Hektor Vula, Manushaqe Hasanaj dhe Lekë Muqaj, përveç detyrave të tyre punës sipas akt emërimit, kryejnë edhe punët shtesë të referentit. Ndërsa Doris Ahmetaj, Diana Zuka dhe Valbone Hoxha kryejnë vetëm punët e referentit në mungesë të tyre.

- Tunë Dushi, vozitës
 - Bilur Idrizi, vozitës
 - Bekim Roka, shtëpiak⁴
 - Ganimete Lloqani, mirëmbajtëse higjienës
 - Hafize Bobanaj, mirëmbajtëse higjienës
 - Lumturie Vataj, mirëmbajtëse higjienës
5. Zyra për Buxhet dhe Financa përbëhet nga:
- Arbnor Dervishi, udhëheqës i zyrës
 - Blerim Shehu, zyrtar shpenzues
 - Nysrete Pruthi, arkëtare
6. Zyra për Informim dhe Komunikim me Media:
- Lekë Muqaj, udhëheqës i zyrës

DEGËT E GJYKATËS

4. Organizimi i Punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega Rahovec

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës – Dega në Rahovec, udhëheq ushtruesi i detyrës të gjyqtarit mbikëqyrës Durim Balaj, së bashku me ndihmës administratori Bujar Sylka.

Mbikëqyrësi i degës duhet t'i raportoi kryetarit të Gjykatës, për punën e Gjykatës të cilin ai drejton, së paku një (1) herë në tre (3) muaj.

Kryetari i Gjykatës, mund të kërkoj nga gjyqtari mbikëqyrës /udhëheqësi i departamentit ose gjyqtarëve të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për ecurinë e lëndëve të veçanta.

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore – Dega në Rahovec, është organizuar dhe paraparë Departamenti i Përgjithshëm, ku për zgjidhjen me efikase të lëndëve në kuadër të Departamentit janë paraparë divizionet si:

⁴ Bekim Roka sipas akt emërimit është roje sigurimi, por me vendim të administratorit është caktuar përkohësisht si shtëpiak

- Divizioni Penal;
- Divizioni Civil;
- Divizioni për Kundërvajtje.

Në Divizionin Penal do të punojë gjyqtari:

- Mizahir Shabani

Mirëpo në këtë degë do të caktohen që të punojnë edhe gjyqtarët e Degës së Malishevës, Njazi Morina dhe Lulzim Paqarizi, të cilët do të ngarkohen me lëndë penale, ndërsa me lëndët e procedurës paraprake vetëm gjyqtari Lulzim Paqarizi.

Në Divizionin Civil do të punojnë gjyqtarët:

- Berkan Hamza;
- Avni Berisha;
- Feim Bytyqi.

Gjyqtarët e Divizionit Civil, do të ngarkohen me lëndët e natyrës civile të gjitha natyrave pa përjashtim.

Në Divizionin për Kundërvajtjes do të punojë gjyqtari:

- Mizahir Shabani

Gjyqtari do të bëjë edhe ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes.

Gjyqtari Mensur Krasniqi është duke vijuar trajnimin në Akademinë e Drejtësisë, i cili nga muaj mars 2025 do të fillojë pjesën praktike në gjykatë dhe atëherë do të vendoset për sistemimin e tij në Divizionin përkatës.

6.1. Zyra e ndihmës Administratorit

1. Zyra e ndihmës administratorit në degën e Rahovecit përbehet nga:

- Bujar Sylka, ndihmës administrator

2. Bashkëpunëtorët profesional:

- Afrim Gashi (lëmia penale)
- Adelina Çmega (lëmia civile dhe skanimi i hershëm i shkresave)
- Armond Qmega (lëmia civile dhe skanimi i hershëm i shkresave)
- Shpresa Rrahmani Bugari (lëmia civile dhe skanimi i hershëm i shkresave)

Bashkëpunëtorët profesional do të angazhohen që të punojnë lëndë penale dhe civile, varësisht nga kërkesat me lëndë.

3. Zyrtarët ligjor/ sekretaret juridike:

- Shani Canziba
- Ilvi Raba
- Albulena Latifi
- Teuta Vuçitërna
- Xhemajli Shala
- Shemsije Shehu

4. Referentët:

- Mizair Sylka
- Ivana Bojiq
- Katarina Miciq
- Ilami Arllati
- Laur Përboqi

5. Shkelzen Zekaj, arkivist

- Është i ngarkuar me punët shtesë të dorëzuesve

6. Ibrahim Haxhimurati, recepsionist

I ngarkuar edhe me punët në pranim.

7. Berat Hasku, IT

8. Rojet e sigurimit:

- Beza Shehu
- Mllagjan Gërkoviq
- Sebajdin Mustara
- Fuat Sharku
- Nisimi Abazi

9. Mirëmbajtëset e higjienës:

- Florije Ejupi,
- Ilvi Dina

7. Organizimi i punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega Malishevë

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës – Dega në Malishevë, udhëheq gjyqtari mbikëqyrës Njazi Morina, së bashku me ndihmës administratori Bardhyl Krasniqi

Gjyqtari mbikëqyrës duhet t'i raportoi kryetarit të Gjykatës, për punën e Gjykatës të cilin ai e drejton, së paku një (1) herë në tre (3) muaj.

Kryetari i Gjykatës, mund të kërkoj nga gjyqtari mbikëqyrës - kryesuesi i Departamentit ose gjyqtarëve të divizioneve, që të paraqesin raporte mujore, ose raporte për ecurinë e lëndëve të veçanta.

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore – Dega në Malishevë, është organizuar dhe paraparë Departamenti i Përgjithshëm, ku për zgjidhjen më efikas të lëndëve në kuadër të Departamentit janë paraparë divizionet si:

- Divizioni Penal
- Divizioni Civil
- Divizioni për Kundërvajtje

Në Divizionin Penal do të punojnë gjyqtarët:

- Njazi Morina;
- Lulzim Paçarizi.

Gjyqtarët do të punojnë të gjitha lëndët e natyrës penale, edhe në procedurë paraprake sipas radhës.

Gjyqtarët krahas me lëndët penale, sipas nevojës do të ngarkohen edhe me lëndët e natyrës së kundërvajtjes, si dhe me ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes.

Në Divizionin Civil do të punojnë gjyqtarët:

- Nehat Qelaj;
- Hatixhe Begaj;
- Petrit Curri.

Gjyqtarët e Divizionit Civil, do të ngarkohen me lëndët e natyrës civile të gjitha natyrave, me përjashtim të lëndëve me njohje të vendimeve të huaja me të cilat do të ngarkohet gjyqtari mbikëqyrësi Njazi Morina.

Në Divizionin për Kundërvajtje do të punojë gjyqtari:

- Shaqir Mazreku.

Gjyqtari i Divizionit për Kundërvajtje, do të punoj edhe në ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes, e deri në kthimin e tij me ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes do të ngarkohet gjyqtari Lulzim

Paqarizi i cili edhe pas kthimit të gjyqtarit Shaqir Mazreku do të vazhdoj të trajtoj lëndë të kësaj natyre, në rast të pengesave ligjore të gjyqtarit Shaqir Mazreku.

7.1. Zyra e ndihmës Administratorit

10. Zyra e ndihmës administratorit në degën e Malishevës përbehet nga:

- Bardhyl Krasniqi, ndihmës administrator

11. Bashkëpunëtorët profesional janë:

- Liman Javori (lëmia civile dhe skanimi i hershëm i shkresave)
- Visar Morina (lëmia civile dhe skanimi i hershëm i shkresave)
- Senad Telaku (lëmia civile dhe skanimi i hershëm i shkresave)
- Samir Morina (pushim pa pagesë)

Bashkëpunëtorët profesional do të angazhohen që të punojnë lëndë penale dhe civile, varësisht nga kërkesat me lëndë.

12. Zyrtarët ligjor/ sekretaret juridike janë:

- Albana Morina – Zogaj
- Alberitë Bibaj
- Behije Karacica
- Fatime Hoti
- Gjavit Morina
- Nexhmije Dakaj

13. Referentët janë:

- Femi Morina, referent në kundërvajtje
- Sanije Bytyçi, referente e ekzekutimeve civile dhe penale

Në këtë degë për shkak të mungesës së referentëve, Sanije Bytyçi është e ngarkuar edhe me të gjitha punët e referentit në lëmin penal.

14. Florim Krasniqi, përkthyes

Në mungesë të referentëve, përkthyesi i kësaj dege është i ngarkuar me detyra shtesë si referent i civil.

15. Muhamet Paçarizi, arkivist

Është i ngarkuar me punë shtesë të pranimit të shkresave dhe postës, lëshimin e certifikatave nën hetime dhe lëshimin e certifikatave me vulën apostile.

16. Besart Begaj, zyrtar i IT-së

17. Syzana Mazreku, zyrtarja për të hyra

18. Hafir Berisha, shtëpiak

19. Agim Kastrati, vozitës

20. Rojet e sigurimit:

- Baki Kastrati
- Skender Buçaj
- Milazim Krasniqi
- Salih Hoti
- Zeqir Hoti

21. Mirëmbajtësit e higjienës

- Misin Mazreku
- Zenel Hoti

8. Zbatimi i Planeve Strategjike të KGJK-së, Akteve dhe rekomandimeve të tjera

Plani Vjetor i Punës për vitin 2025 i Gjykatës Themelore në Gjakovë, përveç se ka të përcaktuar strukturën organizative të gjykatës dhe funksionet e saj, ka paraparë edhe zbatimin e Planeve Strategjike të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës⁵, akteve, rekomandimeve të dhëna nga institucionet tjera, si:

1. Plani Strategjik për Efikasitetin e Trajtimit të rasteve të Korrupsionit, Keqpërdorimit të Detyrës Zyrtare dhe Krimit të Organizuar 2025-2027,
2. Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025,
3. Plani Strategjik për Komunikim me Media,
4. Rekomandimet nga Zyra Kombëtare e Auditimit,
5. Planit për Drejtësi Procedurale,
6. Planit të SKGJK-së për Menaxhimin e Pasurisë,
7. Rekomandimet e dhëna nga Njësia për Inspektim Gjyqësor,
8. Aplikimin e Udhëzuesit të Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, si dhe rekomandimet që dalin nga monitorimet e organizatave ndërkombëtare dhe vendore, të cilat kanë të bëjnë me punën e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe degëve të saj.

⁵ KGJK

9. Shqyrtimet Gjyqësore, Publikimi i Orarit të Mbajtjes së tyre, Publikimi i Vendimeve Gjyqësore dhe Respektimi i Gjuhëve Zyrtare

Shqyrtimet gjyqësore caktohen nga gjyqtarët, përkatësisht kryetarët e trupave gjykuese, konform dispozitave ligjore dhe të njëjta publikohen në ueb faqen zyrtare përmes programit të SMIL-it dhe në monitorët e gjykatës.

Lëndët e korrupsionit, lëndët kur të akuzuarit ndodhen në paraburgim, si dhe lëndët me prioritet ligjor, me qëllim që të sigurohet trajtim efikas dhe i shpejtë i tyre, shqyrtimet gjyqësore do të caktohen në bllok.

Ashtu si në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2025, do të vazhdohet dërgimi i vendimeve gjyqësore sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike për në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë, brenda afateve.

Të gjitha shqyrtimet gjyqësore do të mbahen në sallat e gjykimit dhe do të bëhet përdorimi i sistemit të regjistrimit të seancave me audio incizime të cilat janë të instaluar në sallat gjyqësore.

Gjyqtarët do të raportojnë në baza mujore mbi numrin e seancave të mbajtura, të shtyra dhe seancave të anuluar, si dhe arsyet për mos mbajtjen e seancave.

Do të zbatohet dhe respektohet legjislacioni për gjuhët zyrtare si në rastet e mbajtjes së seancave, ashtu edhe më përkthimin e shkresave në gjuhën zyrtare të palëve.

10. Ndarja e Lëndëve

Ndarja e lëndëve në punë për secilin gjyqtarë, bëhet në mënyrë elektronike, bazuar në programin TIK/SMIL.

Nëse gjyqtarit të cilit i është caktuar lënda, duhet përjashtuar për arsyet e ndryshme, lënda duhet të caktohet trupit tjetër sipas ndarjes elektronike, vetëm në raste dhe për shkaqe të arsyeshme, mund të ketë përjashtim nga rregulla e ndarjes elektronike të lëndëve.

Nga rregulli i ndarjes elektronike të lëndëve, do të përjashtohen lëndët e dhunës në familje (civile), ku janë të caktuar gjyqtarët që do t'i trajtojnë lëndët e kësaj natyre.

Të gjithë gjyqtarët e caktuar në procedurën paraprake, në Departamentin për Krime të Rënda dhe Divizionin e Përgjithshëm, duhet të jenë në gatishmëri të detyrës, për periudhën që do të caktohen me orar të veçantë të punës.

Gjyqtarët e procedurës paraprake, të cilët kanë lëshuar urdhëresa apo kanë ndërmarr veprime si gjyqtarë i procedurës paraprake, do të vendosin edhe për kërkesat për sigurimin e prezencës së të pandehurit, gjegjësisht do të veprojnë si gjyqtarë i procedurës paraprake në këtë çështje, deri në përfundim të procedurës paraprake, pavarësisht se kërkesat, mund të pranohen edhe në periudhën kohore, kur nuk është kujdestar.

11. Radha e Zgjidhjes së Lëndëve

Në parim lëndët zgjidhen sipas radhës së arritjes në gjykatë.

Përgjashtimisht nga kjo rregull kanë lëndët me përparësi ligjore të cilat zgjidhen brenda afateve ligjore ose afateve të arsyeshme me kusht, që edhe ato duhet të vendosen sipas radhës së arritjes në gjykatë, si ato me paraburgim, lëndët e korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, lëndët e shënjestruara, dhunës në familje, alimentacionit, masat e përkohshme, kontestet e punës, pra do të duhet të bëhet zbatimi i strategjive të KGJK-së për zgjidhjen e lëndëve.

Si datë e arritjes në gjykatë, llogaritet data kur në aktin/shkresën – parashtresën e pranimi është vendosur vula me datën dhe kohën e pranimi në gjykatë.

Me qëllim të arritjes së efikasitetit siç parashihet me Planin Strategjik për Qasjen në Drejtësi 2022-2025, gjyqtarët lëndët nga Kapitulli XXXIII – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, veprat penale të vrasjeve, grabitjeve, trafikimi me njerëz, si dhe të gjitha rastet ku të akuzuarit gjenden në paraburgim, shqyrtimet gjyqësore të caktohen në bllok në mënyrë që të përfundojnë sipas afateve ligjore.

12. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe arkivimi

Gjykata Themelore në Gjakovë dhe degët e saj edhe në vitet paraprake kanë treguar rezultate të mira në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, andaj edhe në vitin 2025 synohet që të vazhdohet me trendin e suksesshëm të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, kjo në bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës, si dhe me Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të ngritjes e efikasitetit në ekzekutimin e dënimeve gjyqësore të formës së prerë.

Pas kalimit në objektin e ri dhe ndërtimit të arkivës, gjatë vitit 2025 si prioritet do të jetë që të gjitha lëndët e plotfuqishme të kompletuara me të gjitha shkresat të arkivohen sipas dispozitave të parapara ligjore. Zyrtari i arkives do të kujdeset në vazhdimësi që të gjitha lëndët që i plotësojnë kushtet ligjore të arkivohen me kohë dhe lëndët e pakompletuara të kthehen te referenti përkatës për kompletim dhe më pas të bëhet arkivimi i tyre.

13. Kolegjet Shqyrtuese

Kolegjet shqyrtuese përbëhen prej tre (3) gjyqtarëve, të cilat kolegje formohen nga kryetari i Gjykatës, bazuar në nenin 418 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale. Kolegji shqyrtues formohet sipas radhës nga vet gjyqtarët e kësaj gjykate, e në rast nevojë mund të delegohen edhe gjyqtarët nga dega e Malishevës dhe Rahovecit dhe anasjelltas.

Përbërja e njëjtë si te kolegjet shqyrtuese, shërben edhe për Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit, bazuar në nenin 96 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Në rast se ndonjëri nga gjyqtarët e caktuar në kolegji, për shkak të pengesave ligjore, mund të mos jetë anëtar i kolegjit, të njëjtit zëvendësohen nga gjyqtarët tjerë.

14. Bashkëpunëtorët profesional

Bashkëpunëtorët profesional angazhohen drejtpërsëdrejti në kryerjen e lëndëve civile dhe penale dhe të njëjtit do të raportojnë për punën e kryer sipas Rregullores Nr.15/22⁶ për Bashkëpunëtorët Profesional të KGJK-së.

Caktimi i bashkëpunëtorëve profesional se në cilën lëmi do të punojnë do të bëhet çdo gjashtë (6) muaj, në mënyrë që secili bashkëpunëtor të mund të punoj në të gjitha lëmit, por ndarja e bashkëpunëtorëve profesional do të bëhet varësisht nga ngarkesa me lëndë civile dhe penale.

Bashkëpunëtorët profesional përpos lëndëve të rregullta do të caktohen së bashku me gjyqtarët në procedurën paraprake dhe do të jenë në gatishmëri gjatë periudhës që do të caktohen me orar të veçantë të punës, si dhe do të angazhohen për skanimin e hershëm të shkresave të pranuar në gjykatë.

Kryetari gjykatës mban mbledhje të rregullta me bashkëpunëtorët profesional çdo dy (2) muaj apo edhe më shpesh, në bazë të nevojave që mund të paraqiten.

Bashkëpunëtorët në baza të rregullta mujore duhet të raportojnë për punën e kryer, gjegjësisht realizimin e normës, ku norma e bashkëpunëtorëve do të llogaritet sipas Udhëzuesit për Normën e Punës së Bashkëpunëtorëve Profesional.

15. Mbledhja e Kolegjiut të Gjyqtarëve dhe Takimet Departamenteve apo Divizioneve

Mbledhjet e kolegjiut të gjyqtarëve do të mbahen ashtu siç është e përcaktuar me Rregulloren Nr.17/24 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, së paku një (1) herë në tre (3) muaj, e po ashtu së paku një (1) herë në tre (3) muaj, do të mbahen edhe mbledhjet e udhëheqësve me gjyqtarët e Departamentit dhe Divizioneve përkatëse.

Kryetari i Gjykatës, një (1) herë në vit gjatë muajit dhjetor, e thërret mbledhjen e kolegjiut vjetor me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe me degët e saja në Rahovec dhe Malishevë, ku bëhet shqyrtimi i punës dhe funksionimit të gjykatës gjatë atij viti, caktimi i gjyqtarëve në departamente dhe divizione, sipas nevojave për arritjen e efikasitetit më të mirë, përbërja dhe menaxhimi i trupave për të gjykuar çështje që kërkojnë trup gjykues, po ashtu hartohet dhe aprovohet plani i punës së Gjykatës për vitin e ardhshëm.

Sipas nevojës kryetari i Gjykatës, mund të thërret mbledhjet e kolegjiut në çdo kohë, për të vendosur dhe diskutuar për çështjet e caktuara që kanë të bëjnë me administrimin e gjykatës, organizimin e punës, si dhe për t'i trajtuar problemet dhe sfidat e punës. Po ashtu edhe gjyqtarët mbikëqyrës mbajnë mbledhjet e kolegjiut me gjyqtarët në degën të cilën e udhëheqin dhe pas mbajtjes së kolegjiut i raportojnë kryetarit të Gjykatës. Rekomandimet e nxjerra nga mbledhjet e

⁶ Rregullore Nr.15/22 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin, Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e marrëdhënies së punës të Bashkëpunëtorëve Profesional

kolegjiumit të gjyqtarëve, duhet të përfillen dhe janë të obligueshme për të gjithë, si për gjyqtarët ashtu edhe për stafin administrativ të gjykatës.

Kryetari dy (2) herë në vit mban mbledhjet e veçanta me gjyqtarët e degës në Rahovec dhe në asaj në Malishevë.

Për organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të kolegjiumit, kryetarin e Gjykatës dhe gjyqtarët mbikëqyrës, i mbështet administratori dhe ndihmës administratori, të cilët përkujdesen që mbledhjet të thirren me kohë dhe gjyqtarëve të ju përcjellët me kohë materiali i mbledhjes. Në të gjitha mbledhjet e kolegjiumit të mbajtura, do të përpilohet procesverbali i mbledhjes, të cilin procesverbal së bashku me raportin tremujor, dërgohen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

16. Ndihma Juridike Ndërkombëtare

Kryetari i Gjykatës, vendos në çdo rast kur kërkohet ndihma juridike ndërkombëtare, përveç kur për kërkesë duhet të vendos kolegji, si dhe për pranimin dhe njohjen e vendimeve civile të gjykatave të huaja vendosin gjyqtarët e divizionit civil.

17. Respektimi i Kodit të Mirësjelljes dhe Orarit të Punës

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe Degët e saja, janë të obliguar që gjatë orarit zyrtar të punës të sillen në mënyrë korrekte, ashtu që veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës duhet të jetë serioze, duke respektuar Kodin e Veshjes dhe Paraqitjes në Sistemin Gjyqësor të Kosovës, Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Të gjithë të punësuarit duhet t'i përmbahen dhe ta respektojnë orarin zyrtar të punës të përdorën kartelat në rastin e hyrje-daljes në punë, si dhe gjatë orarit të pushimeve, e po ashtu gjatë orarit zyrtar të punës, duhet të mbajnë kartelat identifikuese (ID kartelat) të vendosura në vende të dukshme.

Gjyqtarët gjatë seancave gjyqësore janë të obliguar që të mbajnë uniformen zyrtare, si dhe të kërkojnë nga prokuroret dhe avokatet, që gjatë seancave gjyqësore të mbajnë uniformen e tyre zyrtare, në të kundërtën konsiderohen se kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës.

18. Zbatimi i Programit TIK/SMIL

Gjykata Themelore në Gjakovë, do të vazhdoj me zbatimin e Programit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili ka treguar sukses në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në punën e gjykatës. Gjatë vitit 2025 të gjitha raportet e gjykatës dhe raportet individuale të gjyqtarëve do të nxjerrën vetëm përmes këtij programi.

Pranimi i aktakuzave dhe të gjitha kërkesave nga ana e prokurorisë, do të vazhdohet të bëhet përmes SMIL-it. Po ashtu, edhe në zyrën e lëndëve në civile do vazhdohet më skanimin e të gjitha shkresave

të pranuar nga palët, ashtu që të gjitha shkresat që gjenden fizikisht në lëndën fizike, të jenë edhe në programin e SMIL-it.

Në vazhdimësi do të punohet që të bëhet barazimi i dosjes fizike me dosjen elektronike në SMIL, ashtu që dosja elektronike të përmbaj të gjitha shkresat e skanuara siç i përmban dosja fizike, e po ashtu të gjitha lëndët më të cilat gjyqtarët janë të ngarkuar fizikisht, të i kenë të ngarkuara edhe me SMIL.

19. Transparenca dhe Llogaridhënia

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për punën e Gjykatës, do të bëhet informimi i vazhdueshëm i publikut për punën dhe aktivitetet e Gjykatës. Publiku në baza ditore do të ketë qasje në orarin e seancave gjyqësore në çështjet penale, civile apo të kundërvajtjes, të cilat do të jenë të publikuara. Po ashtu do të jenë publike statistikat për punën e gjykatës, si raportet e punës, me çka publikut do t'i mundësohet të ketë qasje në të gjitha aktivitetet e gjykatës.

Gjatë viti 2025 synohet të bëhet rritja e publikimi vendimeve gjyqësore, për publikimin e të cilave kompetent do të jetë zyra e gjyqtarit në koordinim me Zyrën për Informim.

20. Organizimi i Punës së Administratës, Trajnimet dhe Vlerësimi i Performancës

Organizimi dhe ndarja e punëve administrative do të rregullohet me një plan të veçantë të punës të miratuar nga administratori i gjykatës, pas konsultimeve me ndihmës administratorët e degëve dhe udhëheqësit e zyrave.

Trajnimet e stafit administrativ dhe të bashkëpunëtorëve do të vijojnë përgjatë vitit 2025, në mënyrë të koordinuar me SKGJK-në dhe akademinë e drejtësisë, të organizuara në grupe të caktuar në mënyrë që të mos pengohet punë e gjykatës dhe të pajtim me Rregulloren Nr.17/23 për Trajnimin e të Punësuarve të Administratës në Sistemin Gjyqësor.

Vlerësimi i performancës së zyrtarëve të administratës do të bëhet në baza vjetore nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, si dhe vlerësimi i punës së bashkëpunëtorëve do të bëhet duke u bazuar në Rregulloren Nr.15/22.

21. Dispozitat Përfundimtare

Të gjithë gjyqtarët sipas nevojës së Gjykatës, për adresimin e çështjeve-lëndëve konkrete, mund të rri-caktohen si në departamente brenda gjykatës, ashtu edhe nëpër degë të gjykatës me aktvendimet përkatëse respektivisht që lëndët, në veçanti të vjetra tu ri caktohen gjyqtarëve, të cilat janë të ngarkuar me më pak lëndë, në veçanti gjyqtarët në seli të gjykatës.

22. Plotësimi dhe ndryshimi i Planit të Punës

Ky vendim mund të ndryshohet dhe plotësohet nga kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, varësisht nga nevoja për organizimin më të mirë të punëve, zgjedhjen më efektive të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të strukturës së gjyqtarëve.

Për çdo ndryshim do të njoftohet me kohë KGJK-ja.

23. Hyrja në fuqi

Plani Vjetor i Punës së Gjykatës është aprovuar më datë 30.12.2024.

Ky Plan Vjetor i Punës do të fillojë të zbatohet nga data 01.01.2025.

Kryetari i gjykatës

Nikollë Kom

